



Organizata për Siguri dhe
Bashkëpunim në Evropë
Prezenca në Shqipëri

**FJALA E KRYETARIT TË PREZENCËS NË TAKIM KOMBËTAR TË
KRYETARËVE TË BASHKIVE PËR "FORCIMIN E KAPACITETEVE
INSTITUCIONALE TË MEKANIZMAVE TË BARAZISË GJINORE NË NIVEL
VENDOR DHE KOMBËTAR NË SHQIPËRI "**

27 qershor 2012

Ministri Ksera,
Zëvendësministri Poni,
Zëvendësministre Kodra,
Të nderuar kryetarë bashkish,
Zonja dhe zotërinj,

Jam shumë i gëzuar t'ju uroj mirëseardhjen sot në një veprimtari që trajton një çështje shumë të rëndësishme në zhvillimin e mëtejshëm të Shqipërisë, si një demokraci e plotë dhe si një shoqëri evropiane.

Prezenca e OSBE-së në Shqipëri ka qenë e vendosur, së bashku me partnerët tanë ndërkombëtarë, për ta mbështetur rritjen e barazisë gjinore në Shqipëri.

Barazia gjinore është një çështje që lidhet ngushtësisht me të drejtat e njeriut, kohezionin social, legjitimitetin demokratik dhe sigurinë.

Unë do të thosha se asnjë shoqëri nuk mund të bëjë hapa madhorë përpara në lidhje me këto çështje, në qoftë se gratë nuk kanë mundësi të gëzojnë të drejta të barabarta me burrat, që do t'i lejonin të realizonin potencialin e tyre në shoqëri.

Barazia gjinore është edhe një detyrim kyç ndërkombëtar. Një fushë ku OSBE-ja, me të drejtë, këmbëngul që të gjitha shtetet e saj pjesëmarrëse t'u përmbahen angazhimeve të tyre.

Zhvillimi drejt një barazie gjinore reale kërkon një kombinim dinamik të lidershit politik, angazhimeve institucionale dhe angazhimit të shoqërisë civile.

Ai kërkon ndryshime të ndjeshme në fusha të ndryshme: nga legjislacioni zgjedhor deri tek një pjesëmarrje më e gjerë e publikut në jetën politike dhe publike, duke çrrënjësuar të gjitha format e diskriminimit ndaj grave.

Progresi në nivel vendor është vendimtar në këto përpjekje.

Përmes nxitjes së integritit të barazisë gjinore në proceset planifikuese vendore, autoritetet krijojnë një mjedis institucional vërtet të bazuar te të drejtat e njeriut – dhe jo te traditat arkaike të dominuara nga meshkujt.

Tradita të papranueshme për një shoqëri evropiane moderne dhe të dëmshme për lulëzimin të këtij vendi dhe, në të vërtetë, të çdo vendi tjetër.

Përveç kësaj, zhvillimi i barazisë gjinore përbën edhe një recetë për një politikë më të mirë publike, të përshtatur sipas nevojave dhe shqetësimeve të të gjithë qytetarëve.

Në një proces të tillë, na duhet të shohim një dialog më të qëndrueshëm institucional me grupet e shoqërisë civile që punojnë në këtë fushë.

Unë i mirëpres hapat pozitivë të ndërmarra nga bashkitë në trajtimin e sfidave ekzistuese, si akordimi i një buxheti, nisja e projekteve të rëndësishme apo prezantimi i planeve vendore të barazisë gjinore.

Tani, Ligji i vitit 2008 për Barazinë Gjinore në Shoqëri kërkoi krijimin dhe fuqizimin e pikave fokale me kohë të plotë të barazisë gjinore si në nivel vendor, ashtu edhe kombëtar.

Pikat fokale të barazisë gjinore luajnë vërtet një rol vendimtar në këtë proces, duke zhvilluar programe dhe politika nga këndvështrimi gjinor.

Ligji u beson gjithë kryetarëve të zgjedhur të bashkive detyra të rëndësishme vendimmarrëse në këtë aspekt kryesor të kapaciteteve institucionale për barazinë gjinore.

Megjithatë, fakti është se ende më pak se një e katërta e punonjësve të barazisë gjinore janë emëruar zyrtarisht me kohë të plotë.

Pra, është e qartë se mbetet ende shumë për të bërë në këtë fushë.

Dhe ne duhet të shohim autoritete bashkiake të vendosura.

Prandaj, unë i inkurajoj fuqishëm kryetarët e bashkive që të ecin përpara dhe të marrin të gjitha vendimet e nevojshme për të finalizuar emërimin e pikave fokale të barazisë gjinore.

Zonja dhe zotërinj,

Ne i mirëpresim përpjekjet që Shqipëria po bën për ta integruar barazinë gjinore në të gjitha fushat e jetës publike.

Megjithatë, retorikat e bukura duhet të shoqërohen me vepra të bukura në të gjitha nivelet.

E thënë thjesht – ligji duhet të zbatohet plotësisht.

Ky është një kusht kyç për çdo vend, për çdo shoqëri që bazohet vërtet te:

Respektimi i lirive demokratike,

Respektimi i shtetit të së drejtës,

Dhe respektimi i të drejtave të njeriut.

Prandaj, unë shpresoj shumë që takimi i sotëm të jetë një vend për ide dhe propozime të reja dhe origjinale.

Prej tyre, i gjithë vendi veçse mund të përfitojë.

Ju faleminderit!

Fund